

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË****KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.12.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, date 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Spartak Braho, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Ermonela Felaj – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Sic u la gjatë seancës që Komisioni i Ligjeve të mblidhet për të bërë një riformulim të amendamentit të propozuar nga dy deputetët, Z.Kopliku dhe z.Baraj. Le të fillojmë diskutimin për riformulimin.

Spartak Braho – Propozoj që të bëhet riformulimi si vijon, Neni 199/b vijon si më poshtë: “Cilido që ofron dhe kryen shërbime sipërmarrjeje, mbikëqyrjeje, zbatim punimesh në një ndërtim të paligjshëm, dënohet me burgim deri në 3 vjet”.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord që ky propozim ti kalojë seancës? Dakord. Miratohet. Ju faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA